

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Lumnije Krasniqi, bashkëpunëtorin Profesional Feriz Berisha, në çështjen penale, kundër të pandehurës **E.G.**, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1. të KPRK-së, e akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.301/18, të dt.15.03.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, PP.II.nr.301/18, të dt.15.03.2018, më dt.**23.05.2018**, jashtë seancës gjyqësore, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.301/18, të dt.15.03.2018, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMORË

E pandehura:E.(S.)G., e lindur me dt....,në P., ku edhe jeton, në rr, "I.K.",nr...., me nr. ID ----, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

S e p s e:

Me dt. 30.12.2017, rreth orës 05:10 min, në rrugën "D.H.", në P., më saktësisht afër zonës "Z.C.", përderisa e pandehura ishte duke drejtuar automjetin e markës "RenaultCapture", më targa të regjistrimit ... në drejtim prej rrugës "T.", në drejtim të rrugës "L.H.", nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik, ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe pasurisë, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 53 të ligjit 05-L-088 të Ligjit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugorë., në atë mënyrë që, dukë mos ia përshtatur shpejtësinë kushteve të rrugës, nga shpejtësia e madhe ka humbur kontrollin mbi drejtimin e automjetit, e ka kaluar në shiritin e kahjes së kundërt të lëvizjes dhe me pjesën e përparme anësore të majtë të automjetit të saj e godet në pjesën e përparme të majtë automjetin e tipit "VW Golf 5", me targa të regjistrimit ...,që po lëvizte në shiritin e tije,pasë kësaj goditje, automjeti "A",është bartur dhe po ashtu e ka goditur edhe automjetin "C", veturën e tipit"VW Passat",në pjesën e pasme, ku si pasoj e këtij aksidenti përveç dëmeve materiale ,lëndime trupore me pasoja të përkohshme për shëndet ka pësuar vozitësit e automjeteve ;E.G.,S.H. dhe A.D..

- **me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të neneve 41, 43, 46, të KPRK-së, si dhe neneve 365 e 495, të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **250 (dyqind e pesëdhjetë euro) €**, të cilin dënim, është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, **me 3 (tri) këste mujore.**

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 (njëzet) € të gjobës.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet procedurale dhe atë në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej **40.88 Euro** dhe në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumë prej **50 Euro**, si dhe në emër të paushallit gjyqësorë do të paguaj shumë prej **20 (njëzet) €**,në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: S.H., me vendbanim në P. rr. "T.S.",nr...., A.D. me vendbanim rr. "Xh.H.", objekti ..., nr...., dhe E.G., rr. "I.K." nr.... në P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktakuzën PP.II.nr.301/18, të dt.15.03.2018, e ka akuzuara E.G. -n, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me arsyetimin së ka prova të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493, të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495, të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: Raporti i Aksidentit 2017-AR-3503, i datës 29.01.2018, ekspertiza e komunikacionit e datës 29.01.2018, e përgatitur nga eksperti i komunikacionit V.K., dhe ekspertiza mjeko-ligjore e datës 21.01.2018, e përgatitur nga Dr.V.K., si dhe foto dokumentacioni me shkresat e tjera, janë prova të besueshme mbi bazën e të cilave vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Pas vlerësimit me shumë kujdes të gjitha provave materiale të lartcekura, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë nga: ekspertiza e ekspertit të komunikacionit **V.K.**, i cili ka konstatuar se deri te aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve teknike të ngasësit të automjetit të tipi “RenaultCaptura”, të cilin e drejtonte **E.G.**,e cila nuk ia ka përshtatur mënyrën e lëvizjes kushteve dhe rrethanave të krijuara në rrugë, pasi që rruga ishte e lagure dhe e rrëshqitshme ,si dhe mosmbajtja e drejtimit të lëvizjes në shiritin e vetë.

Në bazë të mendimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr. **V.K.**, të datës 21.01.2018, për të dëmtuarin, lidhur me natyrën dhe shkallën e lëndimeve trupore rezulton se të dëmtuarit: E.G., si pasojë e aksidentit ka pësuar ndrydhje(mbretje)të indeve të buta të regjionit ballor të kokës,të gjurit të këmbës së majtë dhe përdredhje të indeve të buta të qafës, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë), dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit, SeadHumollisi pasojë e aksidentit ka pësuar ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit ballor të kokës, të regjionit të bërrylit të dorës së majtë me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë), dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit, dhe Argtim Dumani si pasojë e aksidentit ka pësuar ndrydhje (mbretje) të indeve të buta të regjionit i dorës së djathtë dhe përdredhje të indeve të buta të qafës, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë), dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lartë, gjykata konstaton se e pandehura **E.G.**, është penalisht përgjegjëse për kryerjen e veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 450 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 1493/18, i dt.23.05.2018

Bashkëpunëtori Profesional
Feriz Berisha

Gjyqtarja,
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.